

PËRGJEGJËSIA NGA PERSPEKTIVA E TEKSTEVE HYJNORE

Hyrje

Përgjegjësia si fenomen lidhet me ndërgjegjen, e cila e orienton të menduarit e njeriut dhe sjellj e tij drejt perspektivës së shëndoshë, që do të thotë se çdo gjë që do të burojë nga individi do të kishte objektivin dhe kuptimin e duhur.

Zbatimi i detyrimeve në përputhje me standardet përkatëse, paraqet vlerë manifestimi të sedrës ndaj Krijuesit të gjithësisë si dhe pasqyron bindjen reale të individit në raport me Zotin, pikënisjen e punës për në rrugë të mbarë dhe reflektim revolucionar kundër veseve korruptive. Mungesa e ndërgjegjes gjatë zbatimit të përgjegjësive, sinjalizon forca sharlatante e hipokrite të individëve dhe grupeve të dështuara.

Zbatimi i përgjegjësive me kompetencë para së gjithash është vlerë shariatike, nga ana tjetër është shtytës i rilindjes së shoqërive të avancuara. Jetësimi i saj me përkushtim, veçmas në fushën e edukimit, paraqet lloj adhurimi të veçantë, për shkak se shkon në vend urdhri hyjnor, i cili kërkon realizim me kompetencë të detyrimeve. S'ka dyshim se zbatimi i urdhëresave hyjnore pasohet me pas edhe me shpërblime të botës së amshuar. Një kulturë e këtillë, e kultivuar në rangun e shprehisë, efektet në aspektin pozitiv i bën të dukshme. Më vonë prodhohen gjenerata kualitative të edukuara në frymën e kësaj vlere, që i bën ata ta ndjejnë veten si të vlefshëm dhe të rëndësishëm në shoqëri.

Realizimi me përkushtim i përgjegjësive gjithsesi krijon ambient për një jetë të lumtur, jetë të dinjitetshme dhe të avancuar, për ndryshe nuk do të kishte kurrfarë shije jeta.

* Prof. dr. Faredin Ebibi, ligjërues i lëndës së Hadithit dhe dekan i Fakultetit të Shkencave Islame - Shkup. E-mail : ebibi.fahrudin@gmail.com; faredinebibi@fshi.edu.mk; tel: ++389 (0) 75 467 305

Përgjegjësitë bashkë me përfitimet duhet të ishin të balancuara me mundësitë e bartësve të tyre. Në të kundërtën, i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi vese-l-em] tërheq vërejtjen për pasoja me efekte negative:

“Nëse çështja i ngarkohet jo kompetentit (jo të përshtatshmit), atëherë prit çastin e fundit”

(Sujuti).

Përgjegjësitë mund të ishin të natyrës fetare, ekonomike, shoqërore, politike etj. Kështu, që të flitet për gamën gjithëpërfshirëse të kësaj teme pothuajse është e pamundur në kuadër të këtij atrikulli, megjithatë fokusi do të ishte në drejtim të përgjegjësisë me kompetencë të fushës fetare.

Përgjegjësia nga perspektiva e teksteve Kuranore

Fenomeni i përgjegjësisë është theksuar në shumë ajete kur’anore, ndër të cilat do të kishim përmendur këtë:

“Ne u ofruam emanetin (obligimet) qiejve, tokës dhe maleve, e ato nuk deshën ta marrin përsipër atë, u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete; dhe ai i bëri padrejtësi vetes, dhe ishte padijshëm”

(Kuran, 33: 72).

Konstatimi i gjithë komentatorëve të Kuranit është se shprehja “emanet” në këtë ajet përfshin të gjitha llojet e detyrimeve, përkatësisht të përgjegjësisë. Ngarkesa me përgjegjësi nga perspektiva e fesë islame nuk konsiderohet privilegj por detyrim, për të cilën i duhet nënshtruar dhënies së llogarisë. Përgjegjësia është atribut që e shoqëron të ngarkuarin gjatë gjithë periudhës sa është i ngarkuar me të. Fillon atëherë kur e kërkon detyra dhe përfundon pas dhënies llogari për atë që është dashur të përmbushet.

Në këtë kuadër, në Kuran është theksuar:

“Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të pamët dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi”

(Kuran, 17: 36).

I ngarkuari me detyrime është përgjegjës për çdo gjë në atë që legjislacioni islam e ka mandatuar. Ndjenja e singertë ndaj përgjegjësisë e ngre nivelin e bindjes, urdhri për të mirë dhe ndalimi nga e keqja shërben si membranë e sigurisë shoqërore. Shoqëria, e cila injoron parimin e urdhrit për të mirë dhe ndalimin nga e keqja, është buzë greminës së shkatërrimit.

“Ata që mohuan të vërtetën nga beni israilët, u mallkuan prej gjuhës së Dautit dhe të Isait, të birit të Mejremës. Kështu u veprua sepse kundërshtuan dhe e tepruan. Ata ishin që nuk ndalonin njëri-tjetrin nga e keqja që punonin. E ajo që bënë ishte e shëmtuar”

(Kuran, 5: 78-79).

Nga dukuritë më të rrezikshme është shkujdesja dhe papërgjegjshmëria ndaj detyrimeve. Është gjendje shpirtërore behavioriste (siç konstatojnë studimet psikologjike), gjendje plogështie e mosinteresimi, pa motivim, duke mos u interesuar fare për ndodhitë e përgjithshme dhe ngjarjet që zhvillohen rreth tij. Kjo gjendje e bën individin të jetë jo kompetent dhe jo të vlefshëm në asnjë segment të jetës.

Përgjegjësia sipas Kurani është amanet, është ngarkesë, është barrë që ka buruar nga amaneti universal:

“ Ne u ofruam emanetin (obligimet) qiejve, tokës dhe maleve, e ato nuk deshën ta marrin përsipër atë, u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete; dhe ai i bëri padrejtësi vetes, dhe ishte padijshëm”

(Kuran, 33: 72).

Shenjë pasiviteti dhe mungesë realizimi cilësor të detyrimeve, është plogështia, zvarritja e punës, mospërgatitja profesionale, përtacia, moskokëçarja dhe neglizhenca. Këto tipare janë jo të pranueshme për çfarëdolloj autoriteti.

“Mos e obligoni veten sa nuk keni mundësi, betohem në Allahun, Ai nuk mërzitet përderisa ju të mërziteni. Ai (Pejgamberi) më së shumti e donte fenë (adhurimin) e atij personi i cili ishte i vazhdueshëm në të”

(Rijadu-s-alihin).

Përgjegjësia nga perspektiva profetike

Përgjegjësia e udhëheqësit ndaj qytetarëve dhe e qytetarëve ndaj liderit të tyre, vjen me prioritet në krye të përgjegjësiave.

“Gjithsecili prej jush është kujdestar dhe gjithsecili prej jush është përgjegjës për gjithçka që ka nën mbikëqyrje dhe nën kujdesje: Kështu, imami (sunduesi, prijësi) është kujdestar për gjithë çfarë ka ai nën sundim dhe është përgjegjës (e përgjigjet) për ata që ai ka në vartësi; edhe burri është kujdestar i familjes së vet dhe përgjegjës për ta; edhe gruaja është kujdestare e shtëpisë së burrit të saj dhe përgjegjëse për të; edhe shërbyesi është kujdestar i pasurisë së padronit të vet dhe përgjegjës për të. M’u duk sikur tha edhe se: Edhe burri është kujdestar i pasurisë së babait të tij dhe përgjegjës për të. Të gjithë ju jeni kujdestarë dhe përgjegjës për gjithçka që keni nën kujdesje e nën vartësi”

(Buhari, 1420).

Zhvillimi i ndjesisë për bartjen e përgjegjësiave duhet të ishte prioritet në planin e edukimit dhe të arsimimit të gjeneratave të reja.

Njeriu shpeshherë është i pakujdesshëm, nxitës i padobishëm për veten dhe shoqërinë, përveç të pajisurit me vigjilencë dhe largpamësi. Islami me kohë ka mbjellë në zemrat e ithtarëve të vet, vetëdijen e dhembshurisë ndaj vëllezërve dhe detyrimeve ndaj tyre.

Nëse pakujdesia ndaj përgjegjësiave është sëmundje që infekton gjithë poret e jetës shoqërore, ndikimi i saj fatal është edhe në sjelljet behavioriste të njerëzve dhe në qëndrimet e ndryshme të tyre në jetë.

Studiues të ndryshëm të fushës së pedagogjisë kanë konstatuar faktin se edukimi i fëmijëve në frymën e dashurisë dhe mirëkuptimit, ka vlerë madhore sepse kontribuon shumë në mbjelljen e dëshirës për bashkëpunim dhe ndjesi për bartje të përgjegjësisë.

Përgjegjësia e çdo individi është të provokojë ndërgjegjen e çdokujt të ketë kujdes ndaj përgjegjësiave përkatëse si pjesëtar në jetë me të tjerët. Ndërgjegjja ndaj përgjegjësisë paraqet vlerë njerëzore, për të cilën nxit dhe motivon feja islame. Socializimi dhe shtrirja e dorës së bashkëpunimit në mes individëve të shoqërisë

dhe veprimi për avancimin e saj, është detyrim fetar.

Zbatimi me kompetencë i përgjegjësive e begaton besimin fetar të individit, besim i cili kërkon nga ai bashkëjetesë dhe zbatim të të drejtave ndaj të tjerëve, me fisnikëri dhe dashuri, me tendencë të arritjes së kënaqësisë dhe mëshirës së plotë të Krijuesit të gjithësisë. Mungesa e vullnetit, përkatësisht neglizhenca ndaj realizimit të përgjegjësive paraqet defekt që zvarrit efektet e kredos së njeriut.

Përgjegjësia në kuptimin e ngarkesës përfshin çdo individ mysliman i cili është në gjendje të ngarkohet me përgjegjësi dhe të zbatojë detyra konkrete, duke i ftuar njerëzit në atë që është e mirë dhe duke i larguar ata nga ajo që është e dëmshme.

Individi është gur themeltar i çdo shoqërie, sepse çdo shoqëri përbëhet nga grupe individësh. Shoqëria nga perspektiva islame është një trup i pandashëm që nuk toleron asnjë pjesë të saj të dëmtohet ose të priset. Ruajtja e tërësisë së saj nga infektimet (anomalitë) ndërlihet me zbatimin praktik dhe me kompetencë të përgjegjësive të çdo anëtarit të saj. Çdo individ, në mënyrë individuale, është përgjegjës për vetveten, është përgjegjës për ruajtjen e interesit të popullit që i përket, është përgjegjës për komunitetin dhe ambientin që e rrethon. Është përgjegjës për realizimin e saktë të veprave të tij. Gjithashtu është përgjegjës për të luftuar të gjitha format e krimit dhe të orientimeve devijante që dëmtojnë shoqërinë.

Vlen të theksohet fakti se vetë struktura e përgjithshme e islamit është përgjegjësi dhe barrë në kraharorin e ithtarëve të vet. Një nga parimet themelore të mesazhit islam është përhapja e asaj që është e mirë dhe rezistenca ndaj çdo të keqeje në kuptim të ruajtjes së shoqërisë cilësore.

Institucion shumë i rëndësishëm mbikëqyrës në historinë e kulturës dhe qytetërimit islam dhe kontrollues për mbarëvatje të rrjedhave shoqërore është "el-hisbeh". Në krye të këtij institucioni ishte vetë i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi vese-l-em]. Themelimi i këtij institucioni kishte për bazë ajetin kur'anor:

"Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit"

(Kuran, 3: 104).

Ebu Hurejre ka treguar se i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi vese-l-em], kaloi pranë një individi i cili ishte duke shitur hurma. Ai kishte futur dorën në brendi të tyre, por ato ishin të lagura njësoj.

-“Ç’është kjo o pronar i ushqimit (i hurmave)?”, - pyeti Pejgamberi [alejhi-s-elam]. - “Janë lagur nga shiu”, - u përgjigj ai.

-“ Pse nuk i ke treguar hapur në mënyrë që t’i shohin njerëzit?” - pyeti Pejgamberit [alejhi-s-elam]. - “Ai, i cili na mashtron (që na bënë hile) ne, nuk është nga radhët tona”, - ia ktheu Pejgamberi [alejhi-s-elam] (Eba Ibrahim, 1998).

Zhvillimi i këtij riti është në kuadër të parimit se urdhri për të mirë dhe ndalimi nga e keqja te gjeneratat e reja, ka rëndësi të madhe. Pikërisht të nisur nga ky motiv këtë institucion disa studiues islamë e llogarisin si shtyllë të gjashtë të fesë islame. Nga perspektiva kur’anore ky institucion është përmendur para institucionit të besimit:

“Jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqia dhe të besoni në Allahun”

(Kuran, 3: 110).

Mbjellja e vlerave etike dhe morale është përgjegjësi, është mekanizëm i zhvillimit të një shoqërie të përsosur.

Mbikëqyrja ose kontrolli i aktiviteteve shoqërore është në shërbim të udhëzimit të individit, grupeve dhe mbarë shoqërisë. Ky udhëzim ose ky kontroll do të ishte në shërbim të vënies në binarë të botëkuptimeve islame dhe vlerave të tij, në shërbim të arritjes së paqes, qetësisë dhe rehatisë.

Autoritetet e këtuja janë trashëgimtarë të pejgamberëve, në kuptim të rezistencës ndaj të këqijave. Ushtrimi i kësaj veprimatë nga perspektiva e legjislacionit islam është “farzi kifaje - detyrim kolektiv”.

Përgjegjësia nga perspektiva e personaliteteve të shquara myslimane

Historia e zhvillimit të kulturës dhe qytetërimit islam, është e mbushur me raste të figurave të shquara, të cilat gjatë ushtrimit të detyrave publike nga njëra anë dhe nga ana tjetër nga ndikimi

i ndërgjegjes, bazuar në bindjet fetare në jetën e tyre, kishte bërë që ata të ishin kulmorë në ushtrimin e detyrave me përgjegjësi publike. E kaluara e tyre ia vlen të merret si model në kuptim të motivimit dhe sensibilizimit të forcave të reja, për arsye se ata ishin të suksesshëm në karrierën e tyre duke lënë gjurmë të pashlyeshme në faqet e historisë. Ishin të suksesshëm sepse kishin frikë për barrën e përgjegjësive. Presioni i besimit që manifestohej në shpirtin e tyre bëri që ata të ishin të kujdesshëm dhe të vëmendshëm në gjithçka që u besohej. Këtë e kanë dëshmuar në gjithë karrierën e tyre gjatë gjithë jetës.

Ebu Bekri, një shok i ngushtë i Muhamedit [sal-lallahu alejhi vese-l-em], në një prononcim të tij:

“Cila tokë do të më kishte mbajtur dhe cili qiell do të më kishte mbuluar, nëse unë them atë që nuk di në Librin e Allahut?”

(Ahmed, 2001).

Kjo flet për nivel të lartë të vetëdijes në kontekstin e përgjegjësive Ngjashëm kështu edhe Zejd b. Erkami ishte shprehur:

“Jemi moshuar dhe jemi plakur, ndërkaq tregimi i haditheve të Pejgamberit [sal-lallahu alejhi vese-l-em] është përgjegjësi e rëndë”

(Dimeshkij, 1418).

Këtë fjalë e kishte thënë pasi ai ishte në moshë dhe të pranishmit kishin kërkuar nga ai që t’u tregojë hadithe. Por, duke qenë i vetëdijshëm për përgjegjësinë dhe për shkak moshës së thyer të tij, iu shmang tregimit të haditheve..

Si përfundim vlen të konstatohet fakti se ndjenja për të mbajtur përgjegjësi është fryt i perceptimit islam për rolin e saj në jetë, i kujdesit ndaj zakoneve (dokeve) të individit dhe të shoqërisë, balancimit midis kërkesave dhe të drejtave dhe zbatimit të obligimeve.

Realizimi me kompetencë i përgjegjësive garanton rrjedhën e suksesit, të shpëtimit dhe të avantazhit. Avantazhet individuale dhe shoqërore lidhen ngushtë me punën e përkushtuar, me bartjen dhe realizimin e çfarëdolloj përgjegjësie. Në mënyrë të veçantë, besimtarët duhet të ishin të bindur në atë se Krijuesi i gjithësisë

e vlerëson çdo vepër që bënnjeriu. Dhe një ditë për çdo gjë njeriu duhet t'i nënshtrohet llogarisë absolute.

Bibliografia

- Ebu Ibrahim, Ismail b. Xha'fer: Hadithu Ali b. Haxher Essa'di An Ismail b. Xha'fer, Mektebetu-r-ushd li-n-eshri vet-evzië, Rijad, 1418 / 1998, 1, 348.
- Ahmed, Muhamed b. Hanbel: Musned imam Ibni Hanbel, mue-s-esetu-r-isale, botimi i parë, 1421/ 2001, 59, 35.
- Ed-dimeshki, Sadrudin Muhamed b. Alaudin: Sher'hu-l-akidetu-t-ahavije, botimi i parë, 1418, 1, 160.